



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit me Karakter Profesional

“Elektro - Mekanikë”

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Dr. Erald Piperi

2. Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha

Qershor 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë profesionale në “Elektro - Mekanikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 699, dt. 26.08.2015
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 430, dt. 17.12.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim Nr. 81, dt. 21.09.2017
8	Cikli i studimit:	Program i Studimit me Karakter Profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/8 (v.a. 2022 – 2023)
18	Numri i studentëve:	14 studentë (v.a. 2021– 2022) 13 studentë (v.a. 2022– 2023)
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional “Elektro - Mekanikë” i licensuar me VKM Nr. 699, datë 26.08.2015, ofrohet nga Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, Kolegji Profesional i Tiranës. Ky program studimi i korrespondon nivelit 5 të Kornizës së Kualifikimeve Shqiptare. Programi realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Elektro - Mekanikë”. Ky program studimi ka kaluar akreditimin e parë me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 81 datë 21.09.2017 për një periudhë 5 vjeçare.

Programi i studimit me karakter profesional “Elektro - Mekanikë” kombinon teorinë dhe praktikën, me synim nxitjen e studentëve për përvetësimin dhe aplikimin e dijeve bashkëkohore dhe inovacionit. Ky program mbështetet nga një staf akademik cilësor, një kombinim i përvojës akademike dhe asaj të aplikuar me përvojë sipërmarrëse, si dhe nga një infrastrukturë mjaft cilësore për zhvillimin korrekt të procesit akademik dhe organizimin e jetës studentore për studentët e Kolegjit Profesional të Tiranës. Programi i studimit me karakter profesional “Elektro - Mekanikë” përgatit profesionistë në zbatimin e metodologjive në fushën e elektro - mekanikës, që kryejnë montimin fizik, instalimin dhe konfigurimin e sistemeve dhe makinerive të automatizuara, realizon zgjidhjet mekanike për projektimin dhe prodhimin e detaleve dhe elementeve të makinerive. Dijet e zgjedhura të elektroteknikës bashkuar me mekanikën e aplikuar i japin mundësi studentit të krijojë dhe të implementojë teknikat bashkëkohore të fushës.

Programi i studimit me karakter profesional “Elektro - Mekanikë” përgatit profesionistë të cilët fitojnë aftësi në:

- instalimin dhe riparimin e defekteve në sektorin e pajisjeve apo linjave industriale të automatizuara;
- komisionimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve apo sistemeve të automatizuara;
- përdorimin e pajisjeve apo sistemeve të automatizuara (operator);
- automatizimin industrial, sistemeve të kontrollit, përpunimit, sistemeve pneumatike/hidraulike, kontrollorët logjikë të programueshëm (PLC), pajisjet metal punuese (CNC), SCADA, programimin e proceseve apo pajisjeve të tjera industriale;
- mbi sistemet e automatizimit të ndërtesave, shtëpive dhe industrisë duke implementuar teknologjinë IOT.

Përgatitja e studentëve mundëson futjen e menjëhershme në tregun e punës për zgjidhjen e problemeve me natyrë elektro mekanike dhe ka një shtrirje të gjerë për t’u përshtatur me lehtësi me evolucionin e vazhdueshëm të teknologjisë. Ambientet laboratorike të Kolegjit Profesional të Tiranës, vizita dhe praktika në terren pranë bizneseve dhe industrisë, i japin studentit mundësinë për të provuar në praktikë dijet teorike të fituara, si dhe përvojën e nevojshme për të pasur sukses në tregun e punës.

Mundësitë e punësimit:

- Në të gjitha degët e industrisë si teknik i lartë në përdorimin, mirëmbajtjen dhe instalimin e sistemeve apo pajisjeve të automatizuara etj. (industritë tekstile, ushqimore, mjekësore, të transportit, agrikulturë, hidrocentrale etj.);
- Në fushën e ndërtimit (atë civile dhe industriale) si instalator i sistemeve inteligjente, ashensorëve, teleferikëve, pajisjeve të kontrollit dhe supervizimit etj;
- Në servise riparimi të pajisjeve apo komponentëve elektro-mekanikë;
- Në industrinë e prodhimit dhe përpunimit të materialeve mekanike;



- Në kompanitë që implementojnë automatizimin e ndërtesave (Smart Building, Smart Home etj);
- Individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e elektro-mekanikës; ose të operojë si drejtues teknik duke shfrytëzuar lejen e ushtrimit të profesionit.

si dhe:

- në kompani që projektojnë, prodhojnë dhe shesin pajisje ose sisteme mekanikë për aplikime të ndryshme;
- në industritë prodhuese të çdo tipi: automobilistike, mekanike, tekstile, kimike, etj, brenda të cilave ndodhen makineri dhe mekanizma të ndryshme;
- në kompanitë që kërkojnë konsulencë në këtë fushë, etj;
- si profesionist i lirë në fushën e analizave, të projektimit dhe administrimit të sistemeve mekanike, në fushat e konstruksioneve, të prodhimit, të sigurisë dhe të administrimit të cilësisë.

[Evidencë 46; Evidencë 5]

Në vitin akademik 2022 – 2023, në programi i studimit me karakter profesional “Elektro - Mekanikë” janë të regjistruar 14 studentë në vitin e parë dhe 13 studentë në vitin e dytë, gjithsej 27 studentë **[Evidencë 6]**.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga dy anëtarë Dr. Erald Piperi dhe Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha, me mbështetjen e koordinatorës së ASCAL, MSc. Rajna Lila.

Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin Prill 2022, me dorëzimin nga ana e Kolegjit Profesional të Tiranës të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës.

Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me Kolegjin Profesional të Tiranës, në datat 02 dhe 03 Shkurt 2023, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Rektorin e Kolegjit, Përgjegjës të Departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, me Grupin e vetëvlerësimit të brendshëm, me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe të zyrave të ndryshme, me studentët e programit të studimit. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Bibliotekë, në Laboratore, si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor.

Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 81, datë 21.09.2017 dhe plotësimi i tyre nga Institucioni:

1. *Të pasurohet në vijim laborator i makinave elektrike dhe laborator i impianteve elektrike në shërbim të formimit praktik në kuadër të këtij program studimi.*

Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion një infrastrukturë laboratorike (<https://kolegjiprofesional.edu.al/laboratori-kpt/>) të përditësuar dhe efikase, laboratore dhe oficina, të vendosura në ambientet e tij.

Laboratorët janë të pajisur me pajisje të ndryshme në përputhje me nevojat e lëndëve të ofruara në kurrikulën e programit të studimit, duke disponuar licensat përkatëse, si dhe manualët për përdorimin e tyre të cilat ju vihen në dispozicion stafit të angazhuar në mësimdhënie.

Përmes dy projekteve Erasmus+ CBHE, Kolegji Profesional i Tiranës ka siguruar financime për blerje pajisjesh, duke vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik laboratorë të rinj.



Laboratorët janë në eficiencë të plotë, nisur nga kujdesi i vazhdueshëm i Institucionit, përmes bashkëpunimit të ngushtë të stafit akademik dhe atij administrative, në rinovimin e pjesëve të konsumueshme dhe mirëmbajtjes së tyre [Mendimi i Përgjegjës të Departamentit; Plani i masave; Evidencë 22].

GVJ vlerëson se ky rekomandim përmbushet plotësisht.

2. *Të përmirësohet nga pikëpamja cilësore gjuhësore terminologjia teknike në syllabuset e lëndëve të këtij program.*

Çdo vit akademik, stafi akademik i Departamentit të Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara rishikon programet e studimit të ofruara dhe syllabuset e lëndëve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, aktet rregullatore të Institucionit, zhvillimet më të fundit të teknologjisë, nevojat e tregut të punës etj [Mendimi i Përgjegjës të Departamentit; Plani i masave; Syllabuset].

GVJ vlerëson se ky rekomandim përmbushet plotësisht.



Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në “Elektro-Mekanikë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” është hartuar në përputhje me interesat kombëtare duke patur në vëmendje synimet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit, në një fushë që kombinon elektronikën dhe elektro - mekanikën dhe duke ndjekur qasjen drejt teknologjisë dhe inovacionit. Ky program adreson nevojën e tregut për formimin në nivelin operacional, të specialistëve në fushën e elektro mekanikës, duke marrë në konsideratë faktin e zgjerimit të kërkesës së tregut të punës në drejtime që kombinojnë dijet në elektronikë, elektro – mekanikë, përdorimi i makinerive komplekse të automatizuara, robotikë, nxitja drejt përdorimit të energjive të rinovueshme me panelet diellore etj.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Kolegji Profesional i Tiranës ofron programe të licensuara të studimeve jouniversitare të larta, me karakter profesional, me jo më pak se 120 kredite [Evidencë 3, neni 31, pika 3]. Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro – Mekanikë” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit [Evidencë 7], si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale. Ky program studimi është hapur që me themelimin e Kolegjit Profesional të Tiranës, si një drejtim inovativ që kërkohet nga tregu i punës, në kombinim të kompetencave në elektronikë dhe elektro mekanikë.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Kolegji Profesional i Tiranës është kolegji profesional i lartë që ofron veprimtari mësimore dhe trajnuese në fusha të ndryshme të arsimit profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike [Evidencë 3, neni 5], duke zgjedhur lirisht programet e studimit që ofron në kuadër të zbatimit të autonomisë akademike, përkundrejt plotësimit të standardeve dhe kërkesave ligjore, si dhe miraton plane, programe dhe tekste mësimore [Evidencë 3, neni 8 pika a dhe b]. Misioni, vizioni dhe objektivat strategjikë janë të përcaktuar qartë në Statutin dhe në Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit, duke e vënë theksin tek të qenit lider në ofrimin e arsimit profesional, krijimin e profesionistëve të aftë në shërbim të shoqërisë dhe ekonomisë etj. Kolegji Profesional i Tiranës zhvillon veprimtaritë e tij me strategji zhvillimi 5 vjeçare. Strategjia e parë 2015 - 2020 [Evidencë 7.1] e vinte theksin në zgjerimin horizontal dhe vertikal të tij (objektivat e se cilës në lidhje me portofolin akademik u realizuan me hapjen e disa programeve të reja të studimit, si: Teknologji e Instalimeve Elektrike, Administrim Zyre). Aktualisht Institucioni ka hartuar Strategjinë e re të zhvillimit 2021 – 2025, [Evidencë 7] duke vënë theksin te cilësia me në qendër studentin. Rregullorja e Kolegjit Profesional të Tiranës [Evidencë 4, neni 4] përcakton strukturën organizative të përbërë nga dy njësi bazë, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Departamenti i

	<p>Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, programet e studimit për secilën prej tyre, si dhe njësitë ndihmëse mësimore dhe administrative [Evidencë 3, neni 15]: (i) laboratorët (në dispozicion të këtij programi studimi janë 10 laboratorë/oficina); (ii) biblioteka; (iii) libraria.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Analiza e parë e tregut për hapjen e këtij programi studimi është pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit 2015 – 2020 [Evidencë 7], ku janë përshkruar analizat dhe argumentet që mbështesin hapjen e këtij programi të bazuar në nevojat e tregut të punës, të mbështetur në të dhëna konkrete, të cilat dëshmojnë kërkesën në rritje për aftësi dhe dije për profesioniste e teknikë të lartë në fushat e ndryshme të industrisë dhe shërbimit.</p> <p>Për organizimin e programeve të studimit dhe planeve mësimore, Institucioni konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës [Evidencë 4, neni 14, pika 5].</p> <p>Gjithashtu, programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme të vendit [Evidencë 5, neni 13, pika 2].</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro – Mekanikë” ofrohet nga Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, që nga themelimi i Kolegjit Profesional të Tiranës në vitin 2015.</p> <p>Aktualisht departamenti ka në përbërje të tij 10 personel akademik efektiv: 2 Prof. Dr. dhe 8 MSc. [Evidencë 6.1] dhe 8 personel akademik me kontratë: 8 MSc. [Evidencë 29/4]. Stafi akademik aktual ka përvojën dhe kualifikimin e duhur për ofrimin e programit të studimit me karakter profesional në “Elektro – Mekanikë” [CV PAE; CV PAK] Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara disponon në funksion të programeve të studimit që ofron 10 Laboratorë/Oficina [Evidencë 22].</p>
<p>Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara në përputhje me fushën e përgjithshme dhe specifike të tij. Në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 31 datë 15.11.2022 “Për procedurat e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji Profesional i Tiranës ka përcjellë pranë MAS propozimin për kodifikimin e programeve [Evidencë 8].</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” ofrohet nga Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, që nga themelimi i Kolegjit Profesional të Tiranës në vitin 2015, në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike dhe profesionale, në një fushë që kombinon elektronikën dhe elektro – mekanikën.</i></p> <p><i>Analiza e parë e tregut për hapjen e këtij programi studimi është pjesë e Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit 2015 – 2020.</i></p> <p><i>GVJ nisur nga RVB dhe takimet në Institutacion konstaton që nuk ka një studim të tregut të punës të përditësuar. GVJ rekomandon hartimin e një studimi tregu 3 – 5 vjeçar për këtë program studimi.</i></p>

	<i>Institucioni disponon infrastrukturën laboratorike dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e programit të studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë”.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Në Statutin e Kolegjit Profesional të Tiranës [Evidencë 3, Kreu II, Kreu III, Kreu IV], si dhe në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të institucionit, përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, por pesha kryesore në lidhje me programin e studimit, mbulohet nga njësia bazë [Evidencë 3, Neni 14].</p> <p>Gjithashtu në aktet rregullatore janë të përcaktuara qartë roli i përgjegjësit të njësive bazë, këshilluesit të karrierës dhe funksione të tjera departamentale. Në mbështetje të proceseve akademike vijnë edhe zyra e kurrikulës, zyra e Informacionit, Mbështetjes dhe Karrierës së Studentit në nivel institucioni.</p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka marrëveshje bashkëpunimi me 4 IAL në Shqipëri [Evidencë 10]: Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Universiteti European i Tiranës dhe Instituti Kanadez i Teknologjisë. KPT është pjesë e Konferencës së Rektorëve [Evidencë 10.1] dhe merr pjesë në forumet e ndryshme të IAL-ve.</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës ka lidhur memorandum me Universitetin e Thesalisë, Greqi [Evidencë 10.2], bashkëpunim i cili ka për objekt shkëmbimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik dhe/ose administrativ, shkëmbim studentësh, bashkëpunim në kërkim, botime etj.</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës është fitues në 5 projekte të rëndësishme, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave, mobilitetit, rritjes së kapaciteteve në nivel institucional duke përfshirë edhe këtë program studimi [Evidencë 11]. Studentët janë pjesë e projekteve, si pjesëmarrës në trajnime/workshop-e, skemave të mobilitetit etj. Në kuadër projektit MOVET, Ref No. EAC/S54/2019 - Pilot VET mobility scheme for the Western Balkans, studentët bashkë me përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ janë bërë pjesë e Workshop-it Design Thinking, 12-14 Prill 2022 për përgatitjet e strategjisë së ndërkombëtarizimit në KPT [Evidencë 11.1, Evidencë 11.2].</p> <p>Në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA, WP5, KPT ka hapur thirrjen për të krijuar një “pool” të ekspertizës së stafit, që mund të ofrojë zgjidhje për biznesin [Evidencë 11.3], e cila është finalizuar me një punim kërkimor shkencor.</p>

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p>	<p>Në përputhje me objektivat e veprimtarisë së Kolegjit Profesional të Tiranës, i cili synon të ndërtojë ura bashkëpunimi me biznesin vendas dhe të huaj, duke mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin eventual të studentëve pas përfundimit të studimeve [Evidencë 3, Neni 6], dhe Strategjinë 2021-2025 [Evidencë 7], marrëdhëniet e bashkëpunimit të vendosura me aktorë dhe institucione vendase, kanë si qëllim kryesor realizimin e praktikave profesionale, si një ndër komponentët kryesor, ku studentët krahas praktikës, të mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes/familiarizimit për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës. Këto marrëdhënie mbahen nga Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Informacionit, Mbështetjes dhe Karrierës.</p> <p>Procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet akteve të brendshme, ku janë parashikuar detyrat dhe roli i aktorëve dhe njësisive të ndryshme të përfshira në këtë proces, brenda dhe jashtë Institucionit [Evidencë 5.1].</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni kujdeset për krijimin e mundësive për zhvillimin korrekt të praktikave mësimore për të gjithë studentët e tij në përputhje me programin e studimit të ofruar [Evidencë 5.2].</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës ka bërë traditë organizimin e panairit të punës në ambjentet e tij, me pjesëmarrjen e mbi 100 kompanive, institucioneve dhe organizatave, që operojnë në tregun shqiptar në fusha të ndryshme për t'ju ofruar lidhje, mundësi të reja, punësim dhe internshipe profesionistëve të së ardhmes [Evidencë 18.1].</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës ka marrëveshje bashkëpunimi me <i>praktika.al</i>, website më i madh i ofrimit të mundësive të internshipeve dhe praktikave profesionale për studentët dhe të sapodiplomuarit në kërkim të mundësive për të ngritur karrierën e tyre profesionale. Kjo kompani bën të mundur ndërmjetësimin e aftësive dhe kërkesave, që studentët kanë me mundësitë dhe ofertat e kompanive të ndryshme në të gjithë Shqipërinë [Evidencë 33].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kolegji Profesional i Tiranës ka marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë shkëmbimin e stafit dhe studentëve, aplikimin në projekte të përbashkëta dhe implementimin me sukses të projekteve të fituara.</i></p> <p><i>Kolegji Profesional i Tiranës falë bashkëpunimeve me biznese dhe kompani vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre. Praktikave profesionale janë një urë e mirë për punësimin e mëtejshëm të studentëve.</i></p> <p><i>GVJ nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion konstaton që Institucioni nuk ka hartuar një raport analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>



Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar zhvillimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, Statutin dhe aktet e tjera rregullatore të brendshme. Kolegji Profesional i Tiranës harton politika dhe ngre strukturat përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, si dhe krijon kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë [Evidencë 3, neni 11].</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, Kolegji Profesional i Tiranës ka themeluar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) e cila kryen punë të vazhdueshme për monitorimin e veprimtarisë së institucionit dhe sigurimin e cilësisë së brendshme.</p> <p>NjSBC është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të institucionit [Evidencë 3, Neni 16; Evidencë 13]. Ajo ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit dhe punon në formën e një ekipi të përbërë nga pedagogë që përfaqësojnë Departamentet e KPT-së, një përfaqësues nga njësitë ndihmëse, një anëtar - ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të KPT, si dhe propozon ndryshime për përmirësimet e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, monitorimit nga ana e strukturave drejtuese, NjSBC-së, marrjes së mendimit të studentëve me sondazhe dhe fokus grupe, si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore.</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe periodik institucional, sikurse dhe të programeve të studimit, vizitat monitoruese të MAS mbi kapacitetet akademike dhe infrastrukurore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik, përbushja e raportimit për verifikimin e kontrollit të ligjshmërisë ndër vite, etj.</p> <p>Mjetet e vëna në dispozicion nga Institucioni përbushin kriteret e përdorimit, funksionimit e sigurisë dhe vlerësohen rregullisht nga autoritete të licencuara [Evidencë 14]. Çdo ambient laboratorik/oficinë është i pajisur me rregullat përkatëse të sigurimit teknik të cilat janë një element i rëndësishëm i orëve të para të mësimin në Institucion.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>	<p>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohet në të gjitha njësitë e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen [Evidencë 13.2].</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si: sondazhe e intervista të studentëve, të të diplomuarve [Evidencë 15; Evidencë 16; Evidencë 17], të personelit akademik</p>

	<p>[Evidencë 6.4; Evidencë 9], të bashkëpunëtorëve dhe partnerëve [Evidencë 11.3].</p> <p>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së personelit akademik kryhet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • praktikës së leksioneve të hapura, e cila zhvillohet në një nga temat e planifikuara, me pjesëmarrjen e kolegëve të interesuar; • vlerësimin të studentëve që kryhet në fund të semestrit, i cili ruan anonimatit e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinionëve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit; • vlerësimin të Përgjegjësit të Departamentit përkatës/ose grupit ad hoc, i ngritur me urdhër të Rektorit, në raste të veçanta të evidentimit të nevojës për përmirësimin e cilësisë; • rezultateve të raporteve të NJSBC-së; <p>Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoriteteve drejtuese.</p>			
Konkluzione	<p><i>Kolegji Profesional i Tiranës bën një punë të mirë në drejtim të sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila koordinon veprimtarinë e saj me të gjithë strukturat e Institucionit duke monitoruar dhe shkëmbyer në mënyrë të vazhdueshme të dhëna dhe informacione.</i></p> <p><i>GVJ nisur nga DVV dhe nga vizita në Institucion rekomandon hartimin e një raporti të detajuar vjetor të NJSBC si përmbledhje e fushave të ndryshme të veprimit të Institucionit, në përputhje me standardet e cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht	X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht	X
---	-----------------------------	----------------------------	-----------------------------	----------

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët e këtij programi studimi janë të vlerësuara me 4-6 kredite (ECTS), punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar 7 kredite, praktika profesionale 10 kredite. Ky program studimi zgjat dy vite akademike. Totali i krediteve që studenti duhet të marrë për t’u diplomuar është 120 ECTS [Evidencë 5.3; Evidencë 5].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” ofron njohuri dhe kompetencat profesionale të nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e Elektro Mekanikës. Aplikimi në praktikë i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet përmes laboratorëve dhe praktikave pranë subjekteve pritëse dhe nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete si: klubet studentore [Evidencë 20], trajnime [Evidencë 21], pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare [Evidencë 11.3].</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Programi i studimit në “Elektro - Mekanikë” është program me karakter profesional 2-vjecar i organizuar në lëndë ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale të nevojshme për formimin e specialistëve në këtë fushë [Evidencë 5].</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve është përcaktuar ngarkesa në kredite për të gjitha lëndët/modulet sipas formave të ndryshme të mësimdhënies leksione/ushtrime/laboratore/praktika [Evidencë 5.3; Syllabuset].</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës është IAL jo publike me statusin Kolegj Profesional i Lartë. Ai ndjek politikën dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studentëve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</p>

lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.							
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Kolegji Profesional i Tiranës nuk ofron program tjetër studimi në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë.						
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Me daljen e Udhëzimit Nr. 31, datë 15.11.2022, “Për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”, Kolegji Profesional i Tiranës ka ndërmarrë procesin e kodifikimit të programeve të studimit që ofron, propozime të cilat janë dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit [Evidencë 8] .						
Konkluzione	<i>Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” ofron njohuritë dhe kompetencat profesionale të nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e Elektro Mekanikës. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuar në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kolegji Profesional i Tiranës ndjek politikat dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes së studenteve bazuar në kriteret dhe afatet ligjore të përcaktuara në aktet ligjore përkatëse dhe në përputhje me kapacitetet e tij në infrastrukturë, burime njerëzore dhe kërkesat e tregut.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyset plotësisht</th> <th>Përmbyset kryesisht</th> <th>Përmbyset plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyset plotësisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht			X
Përmbyset plotësisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht					
		X					

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë”. Departamenti, si pjesë e strukturës është njësia bazë mësimore dhe kërkimore. Organigrama e Kolegjit Profesional të Tiranës është e bazuar në funksione dhe segmente sipas parashikimeve në Statutin e tij [Evidencë 3; Evidencë 3.1].</p> <p>Në funksion të departamentit janë dhe njësi të tjera si: sekretaria mësimore dhe stafi administrativ, të cilët bashkërendojnë punën e tyre për realizimin sa më efikas të proceseve të ndryshme brenda departamentit.</p> <p>Në programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës së tyre në universitete publike/private shqiptare, në universitete të huaja dhe në kompani të profilit duke sjellë</p>

	<p>eksperiencën e tyre si mësimdhënës në Kolegjin Profesional të Tiranës [Evidencë 6.1].</p> <p>Departamenti zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin e aplikuar. Kolegji Profesional i Tiranës është institucion i akredituar së pari me VBA Nr. 66, datë 21.09.2017, “Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë”, rinovuar me VBA Nr. 08, datë 27.01.2023.</p> <p>Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit, dhe është ngritur me Urdhër të Rektorit të Kolegjit, Nr. 5/3 Prot., datë 10.11.2022 “Për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm” [Evidencë 2].</p>		
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara si njësi bazë për programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për realizimin e procesit akademik, si dhe të praktikave mësimore për çdo lëndë sipas disiplinave përkatëse. Për realizimin e praktikave mësimore në programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë”, Departamenti, përveç stafit akademik mbështetet nga sekretaria mësimore dhe stafi administrativ. Për zhvillimin e praktikave mësimore sipas lëndëve përkatëse Departamenti ka në dispozicion 10 laboratore/oficina, si dhe laboratorin më të ri Smart LAB i krijuar në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA [Evidencë 22] dhe KPT HUB, klubi i inovacionit të Kolegjit Profesional të Tiranës [Evidencë 20].</p>		
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara, si njësi bazë për programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” ka caktuar MSc. Ilir Palushi si pedagog koordinator, përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale. Gjithashtu, për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale, në mbështetje të Departamentit është edhe Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara në Kolegjin Profesional të Tiranës zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe standardet e cilësisë në Arsimin e Lartë, të reflektuara edhe në aktet rregullatore të Institucionit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë,</p>	<p>Departamenti dhe çdo anëtar i personelit akademik dhe administrativ, ka akses të plotë në aktet rregullatore të Institucionit, por edhe në</p>

<p>përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>kurrikulat e programeve të studimit, planet mësimore, syllabuset, rregulloret e programeve të studimit etj. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Të dhënat e detajuara për programin e studimit gjenden edhe në faqen e internetit të KPT (https://kolegjiiprofesional.edu.al/programe/elektro-mekanike/ si dhe në strategjinë e zhvillimi të tij [Evidencë 5.6].</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Lëndët janë të organizuara sipas disiplinës në leksione, ushtrime dhe laboratore të përcaktuara qartë në planin mësimor sipas ngarkesës së krediteve [Evidencë 5.3]. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Këto të dhëna detajohen edhe në kurrikulën, syllabuset dhe rregulloren e programit të studimit [Syllabuset].</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kriteret e pranimit në Kolegjin Profesional të Tiranës miratohen me Vendim të Senatit Akademik, depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale të Kolegjit. Gjithashtu, në rregulloren e Kolegjit dhe rregulloren e programit të studimit jepen informacionet dhe kriteret e përgjithshme për pranimin e studentëve, informacionet e nevojshme lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e lëndëve [Evidencë 4, neni 24, neni 31; Evidencë 5, neni 2, neni 12], të cilat vihen në dispozicion të studentëve dhe janë të shpalluara në ambientet e shkollës.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e çdo lënde në programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” janë hartuar në përputhje me kriteret ligjore dhe me ngarkesën e përcaktuar në planin mësimor [Evidencë 5.3; Syllabuset]. Syllabuset e lëndëve janë të hartuara sipas një formati të miratuar në nivel institucioni, ku paraqitet informacioni i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë, të organizuara në leksione, ushtrime dhe laboratore [Syllabuset]. Syllabuset miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit dhe hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse.</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.</p>	<p>Në kuadër të përditësimit të kurrikulave, duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës, në përputhje dhe me zhvillimin e teknologjisë, departamenti lidhur me programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” bën ndryshimet e nevojshme në përditësimin e syllabuseve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion apo kurrikulës sipas rregullores së brendshme dhe akteve nënligjore në fuqi [Evidencë 5.7]. Kolegji Profesional i Tiranës, me anë të pjesëmarrjes në evente, studimeve të tregut, kontakteve intensive me biznesin, synon të jetë i azhurnuar me dinamikën e trendeve ekonomike, sociale dhe kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të reflektojë këto përkatësisht edhe në ofertën e tij akademike [Evidencë 5]. Gjithashtu, Kolegji Profesional i Tiranës shqyrton kërkesat dhe nevojat e tregut për programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” dhe pasqyron ndryshimet sipas rregullores në këtë program studimi. Syllabuset përditësohen dhe miratohen përpara fillimit të çdo semestri,</p>

	për të garantuar përmirësimin dhe përditësimin e informacionit të nevojshëm.		
Konkluzione	<i>Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Instucioni kujdeset në përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve në përputhje me nevojat e tregut, ndryshimet më të fundit teknologjike dhe literaturën bashkëkohore.</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit		Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	Në Programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë njohuri bashkëkohore dhe tërheqëse për studentët, duke mundësuar qasje efektive në tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive të studentëve për një punësim të suksesshëm. Ndërthurja e njohurive teorike (leksione, etj.) me ato praktike (ushtrime, laboratore, praktika mësimore, etj.) [Evidencë 5.3] i jep të diplomuarit në këtë program studimi kompetenca profesionale të mjaftueshme për t’u punësuar si teknikë të kualifikuar në tregun e punës, vendas e të huaj, konkretisht në të gjitha degët e industrisë si teknik i lartë në përdorimin, mirëmbajtjen dhe instalimin e sistemeve apo pajisjeve të automatizuara etj. (industritë tekstile, ushqimore, mjeksore, të transportit, agrikulturë, hidrocentrale etj.); në fushën e ndërtimit (atë civile dhe industriale) si instalator i sistemeve inteligjente, ashensorëve, teleferikëve, pajisjeve të kontrollit dhe supervizimit etj.; në servise riparimi të pajisjeve apo komponentëve elektro-mekanikë; në industrinë e prodhimit dhe përpunimit të materialeve mekanike; në kompanitë që implementojnë automatizimin e ndërtesave (Smart Building, Smart Home etj.). Individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi privat në fushën e elektro-mekanikës, ose të operojë si drejtues teknik duke shfrytëzuar lejen e ushtrimit të profesionit.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Viti akademik është i organizuar në 2 (dy) semestra me kohëzgjatje normale 15 javë [Evidencë 5, neni 3 (3)]. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestra është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional të studentit. Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shprehjet, që fitohen të jenë në vijimësi të njëra-tjetrës. Kreditet e lëndëve ndahen sipas aktiviteteve formuese të saj leksione/ushtrime/laboratore/ praktikë profesionale duke bërë të mundur ruajtjen e një raporti proporcional ndërmjet aktiviteteve teorike dhe aktiviteteve praktike të saj.
Kriteri 3. Programi i studimit ka një	Programi i studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë”

<p>raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>është i organizuar sipas komponentëve mësimorë më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lëndë bazë (A) – 15 ECTS – 12.5% - Lëndë karakterizuese (B) – 54 ECTS – 45%; - Lëndë ndërdisiplinore/integruese © - 24 ECTS – 20%; - Lëndë plotësuese (D) – 20 ECTS – 16.7%; - Detyrime përmbyllëse (E) – 7 ECTS – 5.8%. <p>Në pjesën më të madhe të lëndëve teknike/karakterizuese aplikohen detyra kursi dhe laboratore, të cilat synojnë të zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve dhe nxisin që ata të përvetësojnë procesin e aftësisimit profesional.</p> <p>Nisur nga natyra profesionale e Kolegjit dhe programeve të studimit që ofrohen, është synuar që praktika të jetë sa më e pranishme në kurrikulën e çdo programi studimi. Duke qenë se synimi është përgatitja e profesionistëve me orientim praktik, theksi është vënë edhe tek ana praktika e vetë lëndëve, e cila kryesisht realizohet në ambientet e vetë Kolegjit dhe në disa raste me vizita në institucione, dhe tek praktika në terren si praktikë profesionale.</p> <p>Praktika profesionale si lëndë shtrihet në 6 javë. Praktika profesionale shërben jo vetëm për aftësimin praktik dhe profesional në terren dhe në vendin e punës të studentit, por që ai të njihet dhe me kulturën e punës dhe kulturën e korporatës, si dhe të gjejë tek subjekti pritës një punëdhënës të mundshëm. Për këtë arsye, praktika zhvillohet në fazën e fundit të studimeve, kur dhe studenti ka krijuar një profil të qartë dhe ka një formim që e lejon të jetë pjesë e vendit të punës, si nga ana profesionale, praktike dhe e aftësive personale, për të qenë më pas një punëmarrës potencial.</p> <p>Pjesë e procesit akademik janë dhe vizitat në terren në biznese dhe industri që kanë lidhje me këtë program studimi [Evidencë 18].</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arrijtjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja e veprimtarive formuese [Evidencë 5.3; Syllabuset] dhe një raport teori – praktikë i ekuilibruar ndërmjet tyre, krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, sipas drejtimit dhe profilizimit dhe objektivave formues të programit, gjë e cila u mundëson studentëve transferimin e studimeve në institucione të tjera dhe punësim në përfundim të studimeve. Gjithashtu, bazuar në parashikimet ligjore, kreditet e grumbulluara gjatë studimeve profesionale të larta mund të transferohen në studimet e ciklit të parë që i referohen nivelit 6 të Kornizë Shqiptare të Kualifikimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>	<p>Programet e disa lëndëve/moduleve karakterizuese janë objekt i diskutimeve për përditësimin e tyre duke u bazuar në literaturën e 5 viteve të fundit [Syllabuset]. Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit. Bashkëpunimet dhe mundësia e hyrjes në biblioteka, ka mundësuar përditësimin e gjerë të literaturës. Krijimi dhe frekuentimi i bibliotekës <i>online</i>, eksperiencat dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, si dhe mobilitetet e stafit akademik në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, në të cilat Kolegji Profesional i Tiranës është pjesëmarrës, kanë ndikuar në pasurimin dhe përmirësimin e syllabuseve [Evidencë 11; Evidencë 11.1; Evidencë 11.2; Evidencë 11.3].</p>
<p>Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës bashkëpunon me emra të njohur të biznesit dhe industrisë, me institucione shtetërore dhe ente të pavarura, ku realizohet praktikë aftësuese në terren dhe ofrohen mundësi punësimi.</p> <p>Bashkëpunimi i frytshëm me sektorin privat dhe punëdhënësit e ardhshëm të studentëve, ngritja e sistemit të tutoriatit dhe analizat</p>

profesionit.	<p>periodike përkatëse, vlerësimet e ndryshme mbi rezultatet e bashkëpunimit me operatorët privatë dhe të sistemit të tutoriatit garantojnë një formim praktik të përshtatshëm të studentëve në përputhje me kërkesat e profesionit të tyre në fushën e Elektro Mekanikës.</p> <p>Në kuadër të projektit Erasmus + CBHE, Usia, në Kolegjin Profesional të Tiranës është ngritur Zyra USIA, si një sistem efikas mbështetës për zgjerimin e rrjetëzimit të tij, bashkëpunimin në kuadër të Heliksit të Katëfishtë (Quadruple Helix), kërkimin dhe transferimin e njohurive, inovacionin dhe aplikimin e teknologjive të reja [Evidencë 11.4].</p>		
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	<p>Përmbajtja e programit të studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitim të dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, për t’u punësuar si teknikë të kualifikuar në tregun e punës, vendas e të huaj në përputhje me nivelin e 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p>		
Konkluzione	<p><i>Organizimi dhe përmbajtja e kurrikulës në module/lëndë në programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” krijon mundësinë për një formim të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës dhe literaturë bashkëkohore, duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës, si dhe transferimin e studimeve në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>GVJ nisur nga DVV konstaton, që në kurrikulën e programit të studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë”, ndarja e veprimtarive sipas komponentëve mësimore C, D dhe E nuk është në përputhje me VKM 185, datë 25.03.2021.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret



Vlerësimi

Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere,

Në kuadër të përditësimit të kurrikulave, duke marrë në konsideratë listën e profesioneve dhe kërkesat e tregut të punës, në përputhje dhe me zhvillimin e teknologjisë, departamenti bën ndryshimet e nevojshme në përditësimin e syllabuseve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion apo kurrikulës sipas rregullores së brendshme dhe aktet nënligjore në fuqi. Kolegji Profesional i Tiranës, me anë të pjesëmarrjes në evente, studimeve të tregut, kontakteve intensive me biznesin, synon të jetë i azhurnuar me dinamikën e trendeve ekonomike, sociale dhe kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të

<p>të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>reflektojnë këto përkatësisht edhe në ofertën e tij akademike [Evidencë 7]. Kolegji Profesional i Tiranës në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar [Evidencë 15; Evidencë 16; Evidencë 17] dhe të personelit akademik [Evidencë 9; Evidencë 11.3]. Përfundimet e nxjerra dhe vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në parashikimet e Statutit [Evidencë 3, Neni 46], studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentorë në nivel njësie kryesore, në nivel institucioni të arsimit të lartë, si dhe në nivel kombëtar. Këshilli i studentëve është organizëm i pavarur i studentëve të Kolegjit Profesional të Tiranës, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqëson interesat e tyre. Ai realizon dhe mundëson pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të Kolegjit, në strukturat mësimore dhe të shërbimeve. Këshilli i studentëve shpreh mendime dhe propozime për probleme me interes të përgjithshëm të Kolegjit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Bazuar në parashikimet e Statutit [Evidencë 3, Neni 46], Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, një përfaqësues për çdo program studimi dhe vit studimi. Përbërja e Këshillit të Studentëve publikohet në faqen e internetit të KPT (https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p>	<p>Çdo vit akademik, njësia bazë në bashkëpunim me anëtarët e departamentit, rishikon programet e studimit dhe syllabuset përkatëse të tij, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, aktet rregullatore të Kolegjit Profesional të Tiranës, dinamikat e teknologjisë, nevojat e tregut të punës, përmasa e ndërkombëtarizimit, përfshirë vlerësimin e punësimit të studentëve si një nga indikatorët matës të performancës së programit. Në kuadër të projektit Erasmus + CBHE “University to Society Innomediarities in Albania: Co-Production of knowledge and research that matters” / U-SIA, që financohet nga Bashkimi Europian, janë organizuar aktivitete (fokus grup) në Kolegjin Profesional të Tiranës me stafin, studentë të tij, kërkues dhe me disa nga partnerët, për të evidentuar marrëdhënien IAL – biznes dhe problematikat në lidhje me të, përfshirë punësimin [Evidencë 11.3].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni nxit përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>



<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në kuadër të programit të studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë”, mësimdhënien është e organizuar në leksione/seminare/laboratore/praktika.</p> <p>Laboratorët zhvillohen në laboratorët e Kolegjit Profesional të Tiranës [Evidencë 22], ndërsa praktika profesionale 6 javore pranë organizatave, kompanive dhe bizneseve me të cilat Kolegji ka marrëveshje bashkëpunimi [Evidencë 4, Kreu VI, Evidencë 5.1].</p> <p>Në kuadër të këtij program studimi zhvillohen edhe forma të tjera transmetimi të dijeve, të tilla si: leksione interaktive, konsultime për çdo lëndë në auditor etj. Gjithashtu, rektorati në bashkëpunim me përgjegjësin e departamentit ka ngritur dhe strukturat përkatëse të stafit pedagogjik (tutoratin) [Evidencë 17; Evidencë 17/1], që monitoron dhe përkujdeset për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor, si në auditor, ashtu edhe në praktikatat profesionale.</p> <p>Një pikë tjetër e fortë është bashkëpunimi i ngushtë me tregun e punës, përmes së cilës, lektorët kanë patur mundësi të ftojnë në orën e leksioneve ekspertë të fushës, të zhvillojnë vizita në biznese dhe praktika në terren.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Stafi akademik i programit të studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” zhvillon mësimdhënien si një ndërthurje e ngushtë midis teorisë dhe praktikës, duke synuar zhvillimin e aftësive praktike të studentëve në fushën përkatëse.</p> <p>Gjatë periudhës së mësimdhënies <i>online</i>, mësimi është zhvilluar në platformën Microsoft Teams, e cila mundëson komunikimin sinkron dhe asinkron, ndarjen e materialeve mësimore, zhvillimin e detyrave etj.</p> <p>Zyra e IT gjatë kësaj periudhe ka ofruar asistencë të vazhduar për stafin dhe studentët përmes manualeve në shqip, video tutorial dhe takimeve online [Evidencë 25]. Kolegji Profesional i Tiranës vuri në dispozicion udhëzime për mësimin, mirëqenien për studentët, duke dedikuar dhe një seksion të posacëm “Mësimi online” në faqen e tij të internetit https://kolegjiprofesional.edu.al/meso-online/</p> <p>Për format alternative të mësimdhënies, bëhet trajnim dhe jepen udhëzime të vazhdueshme nga Zyra e IT.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe</p>	<p>Kolegji Profesional i Tiranës mbështet stafin akademik në rritjen e mëtejshme profesionale dhe synon inkurajimin e tyre për të ndjekur seminarat, mbledhje apo forume të ndryshme, pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare që i aftësojnë ata në rritjen e kapaciteteve, në metoda të mësimdhënies, si dhe formimit të tyre akademik [Evidencë 25; Evidencë 11.5].</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës nxit organizimin e orëve të hapura si një</p>

<p>nevojave të studentëve.</p>	<p>formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie, duke organizuar trajnime të stafit nga vetë Kolegji dhe/ose me anë të palëve të treta [Evidencë 6.2].</p> <p>Kolegji Profesional i Tiranës favorizon pjesëmarrjen e stafit në jetën sociale, kulturore, veprimtari të tjera të organizuara nga IAL, si p.sh. pjesëmarrjen në konkurse, hackathone, kore etj. [Evidencë 6.5].</p> <p>Gjithashtu anëtarë të stafit janë angazhuar në cilësinë e kërkuesit në projektin Erasmus + CBHE USIA dhe Engine [Evidencë 11].</p> <p>Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë të procesit akademik dhe të institucionit, duke vlerësuar rëndësinë që ka mendimi i stafit, Kolegji Profesional i Tiranës ka ndërmarrë zhvillimin e një ankete, me anë të një pyetëso. Qëllimi i pyetëso është të marrë informacion mbi qëndrimin dhe qasjen e stafit në lidhje me disa elementë të caktuar të procesit akademik, për të evidentuar pika/nevoja për ndryshim dhe/ose përmirësim, praktika të mira për të ndarë me njëri – tjetrin etj. Të dhënat shërbejnë si tregues, në mënyrë që të merren masa kur është e mundur nga organet dhe autoritetet përkatëse sipas kompetencës [Evidencë 6.4].</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në programin e studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” është i angazhuar në mësimdhënie staf akademik i kualifikuar me eksperiencë akademike dhe profesionale të fituar ndër vite gjatë punës së tyre në universitete publike/private shqiptare, në universitete të huaja dhe në kompani të profilit duke sjellë eksperiencën e tyre si mësimdhënës në Kolegjin Profesional të Tiranës [Evidencë 6.1].</p> <p>Pedagogët përdorin metoda interaktive gjatë zhvillimit të lëndëve me qëllim arritjen e bashkëpunimit, si dhe përmirësimin e njohurive duke futur edhe koncepte të reja nga fusha teknologjike dhe ajo e zbatimit të tyre për të nxitur interesin dhe vullnetin e studentëve.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Departamenti i Elektro Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Në këtë kuadër një rëndësi të veçantë kanë edhe sugjerimet që vijnë nga studentët dhe të diplomuarit përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve [Evidencë 15; Evidencë 16; Evidencë 17].</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të</p>	<p>Në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Kolegjin Profesional të Tiranës është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila është njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të tij. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të Kolegjit, si dhe propozon ndryshime për përmirësimet e nevojshme. Për ushtrimin e funksioneve të saj, NJSBC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia përbëhet nga Kryetari, nga anëtarët, që përfaqësojnë çdo departament, personeli ndihmës – akademik ose administrativ, një përfaqësues nga jashtë institucionit si ekspert për çështje të vlerësimit, si dhe një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve. Mënyra e funksionimit të NJSBC-së rregullohet me rregullore të veçantë [Evidencë 13.1; Evidencë 13.2].</p>

metodave të reja.			
Konkluzione	<i>Kolegji Profesional i Tiranës kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Institucioni nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Sistemi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, ka si qëllim vlerësimin e vazhdueshëm të njohurive të studentëve. Kriteret dhe mënyra e vlerësimit janë të përcaktuara në dokumentat rregullatorë të Kolegjit Profesional të Tiranës [Evidencë 4; Evidencë 5]. Studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit me kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive. Mënyra e vlerësimit është rubrikë e çdo syllabusi, dhe pedagogu jep udhëzimet përkatëse në auditor në fillim të zhvillimit të lëndës. Kontrollet e njohurive ruajnë anonimatën e studentit duke përdorur barkode të vëna në dispozicion nga sekretaria mësimore.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/punë laborator, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës ai mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngrë një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve është i ndarë në disa komponentë që parashikohen në rregulloren e programit të studimit: <ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar; • Kolokiume/detyra kursi/laboratorë; • Aktivizimi në seminare/ushtime. [Evidencë 5, neni 8] Në lidhje me praktikën profesionale, në përfundim të praktikës, studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën e fituar në subjektin pritis [Evidencë 5.1] , që mbrohet para një komisioni.
Konkluzione	<i>Institucioni në rregulloren e përgjithshme, rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e praktikave profesionale përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga</i>

	<i>studentët për çdo lëndë, duke garantuar aftësimin e tyre në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.



Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Përgatitja e studentit vlerësohet në mënyrë të vazhduar gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është kombinim i elementëve të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar (60%); • Kolokiume/projekte/laboratore (30%); • Aktivizimi në ushtrime (10%). Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së saj. Propozimi bëhet nga pedagogu i lëndës dhe përcaktohet në syllabusin e saj, pasi ka marrë miratimin e Përgjegjësit të Departamentit [Evidencë 5] .
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit, derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre [Evidencë 4; Evidencë 5; Evidenca 27] .
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Përgatitja e studentit vlerësohet në mënyrë të vazhduar gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është kombinim i elementëve të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> • Provimi përfundimtar (60%); • Kolokiume/projekte/laboratore (30%); • Aktivizimi në ushtrime (10%). [Evidencë 5]
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Stafi akademik vlerëson secilin student dhe ofron mbështetje për përmirësime rezultatesh apo ecuri të mëtejshme të suksesshme për to. Kryesisht testimet shoqërohen me komente për orientimin e problematikave duke evidentuar mangësitë dhe problemet e hasura në formatin e testit. Gjithashtu, stafi akademik synon të kryejë seanca sqaruese pasi rezultatet të jenë bërë publike nga sekretaria mësimore, për të rritur komunikimin dhe transmetimin e mesazheve nxitëse në përmirësim të mëtejshëm të studentit.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Kolegji Profesional i Tiranës gjatë procesit të provimeve/testimit të njohurive organizon një menaxhim të mbikëqyrjes së studentëve, për të garantuar një proces cilësor, të qetë dhe të rregullt duke shmangur kopjen dhe prishjen e rregullit. Gjatë gjithë vitit, stafi akademik vlerëson detyrat e studentëve me korrektësi duke evidentuar dhe ndaluar ripërdorimin e informacionit

	<p>të padëshmuar me referencë apo citim, plagjiaturat në detyra, punëve laboratorike dhe mbrojtjes së praktikave.</p> <p>Në rast përsëritjeje të plagjiaturës ose të kopjimit, emri i studentit shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe studenti paralajmërohet për përjashtim nga Institucioni. Herën e tretë të përsëritjes së kopjimit ose të plagjiaturës studenti përjashtohet nga Institucioni dhe humbet çdo të drejtë financiare që mund t'i takojë në bazë të kontratës së lidhur me Kolegjin Profesional të Tiranës [Evidencë 4, neni 50]. Kolegji ka miratuar Kodin e Etikës dhe të Integritetit, një dokument publik, i cili zbatohet nëpërmjet procedurave dhe mekanizmave të qarta [Evidencë 47].</p>			
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Vlerësimi i studentit me pikë duhet të jetë i detajuar për çdo pyetje dhe shënohet në fletën e provimit, me bojë dhe në tabelën përmbledhëse të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Për studentin, që nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, Sekretaria Mësimore në procesverbalin përfundimtar të lëndës bën shënimin “Nuk u paraqit” [Evidencë 5, neni 8]. Vlerësimi për komponentët e tjerë të vlerësimit duhet të dorëzohet përpara zhvillimit të provimit përfundimtar dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve.</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit [Evidencë 5, neni 8, pika 6] parashikon të drejtën e ankimit/apelit të studentit. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (kolokium, detyrë kursi/detyra praktike/punë laborator, provim përfundimtar), pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës mund t'i drejtojë Përgjegjësit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Më pas, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore.</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar [Evidencë 5].</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni në rregulloren e përgjithshme dhe në rregulloren e programit të studimit përcakton procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë, si dhe ju jep mundësinë studentëve të ankimojnë vlerësimin, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimit.</i></p> <p><i>Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturen nga ana e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit (Evidenca 5.3 Plani mesimor.pdf) përmban module dhe lëndë bazë, lëndë karakterizuese dhe plotësuese, nëpërmjet të cilave studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të manaxhimit dhe vendimmarrjes së biznesit.</p> <p>Bazuar në Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf ky program studimi ka si prioritet formimin e profesionistëve të orientuar drejt njohurive dhe aftësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> njohuri tekniko-praktike që kërkohen nga fusha të ndryshme të aplikimeve të elektro mekanikës; aftësi për zgjidhjen e problemeve tekniko-industriale dhe për t'u përshtatur me lehtësi me evolimin e vazhdueshëm të teknologjisë; njohuri të plota mbi materialet dhe zgjidhjet mekanike për projektimin dhe prodhimin e detaleve dhe elementeve të makinave. eksperiencë praktike profesionale për të pasur sukses në tregun e punës.
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit (Evidenca 5.3 Plani mesimor.pdf), GVJ konstatoi se modulet/lëndët janë në përputhje me zbatimin e VKM 41/2018 të ndara në lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse.</p> <p>Bazuar në Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf dhe në takimin me studentët dhe lektorët e këtij programi studimi, programi garanton një sërë njohurish të përshtatshme për tregun e punës dhe GVJ mendon se specialistët e formuar në këtë fushë mund të jenë eficientë në tregun e punës dhe të pajisur me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me këtë treg</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Vlerësimi i studentit (Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf), në fund të një lënde të ndjekur bëhet duke u bazuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrje dhe aktivizim (10%) Provim i ndërmjetëm, detyrë kursi, laboratorw; (30%) Provim përfundimtar (60%) <p>Bazuar në rregulloren e IAL-së (Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf) këto elementëkanë peshën e tyre me qëllim që studenti të ketë një vlerësim të vazhdueshëm në lidhje me lëndën e ndjekur.</p> <p>GVJ mendon se kjo mënyrë vlerësimi bën të mundur një vlerësim të drejtë të studentit dhe e nxit atë të angazhohet në të gjithë elementët e vlerësimit.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë</p>	<p>GVJ konstatoi se përbërja e kurrikulës së programit të studimit, lëndët dhe modulet që e përbëjnë atë, janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që</p>



<p>studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>t'i pajisin studentet me aftësi për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Kurikula e programit të studimit përmban zhvillimin e praktikës mësimore në vitin e dytë. Hartimi i planit mësimor (<u>Evidenca 5.3 Plani mesimor.pdf</u>) është bërë në mënyrë të tillë që t'i japë hapësirë studentit për të zhvilluar praktikën mësimore dhe atë profesionale. Praktika profesionale zhvillohet për 1 muaj pa ndërprerje, dhe studenti duhet të plotësojë 120 orë të subjekti për të. <u>Evidenca 5.1 Rregullorja e praktikave profesionale.pdf</u></p> <p>Ky organizim i kurrikulës u jep mundësinë studentëve për t'i zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e fituara në trajtimet e programit të studimit në praktikë.</p> <p>Institucioni ka projekte në të cilat përfshihen studentët dhe ka mobilitete të shumta, por studentët e këtij programi studimi nuk janë përfshirë ende në këto projekte.</p>		
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>KPT organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët e KPT, si dhe zhvillimet e fundit në vend (<i>si ReMany, Ujësjellës Kanalizime Tirana etj</i>). <u>Evidenca 31 Takimi me biznese.pdf</u></p> <p>Në nivel departamenti gjithashtu organizohen orë të hapura, ku diskutohen zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë dhe impakti që kanë këto zhvillime me këtë program studimi.</p> <p><u>Evidenca 49 Prezantimet ne departament.pdf</u></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ta nëpërmjet laboratorëve, praktikave profesionale si edhe trajnimeve të ndryshme.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion si dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL-ja ka hartuar dhe ndjek veprimtarinë e studentit deri në përmbylljen e studimeve të tij. Studenti është nën vëmendjen e lektorëve dhe institucionit për përmbushjen e detyrimeve dhe mbylljen me sukses të procedurave të posaçme të hartuara për realizimin e diplomimit.</p> <p>Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se pedagogu i lëndës para fillimit të çdo semestri bën prezantimin e</p>

	<p>përmbajtjes së lëndës, objektivat dhe temat e lëndës si dhe elementët e tjerës të syllabusit. Gjithashtu i njuh studentët me metodologjinë e vlerësimit të dijeve gjatë semestrit dhe me përfundimin e lëndës.</p> <p>Grafiku i zhvillimit të provimeve hartohet nga përgjegjësi i njesisë bazë dhe miratohet nga Dekani. Studentët informohen në lidhje me datat e provimeve me anë të Sistemit Classter (<u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u>). Në formën e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë. Tezat e provimit hartohen nga pedagogu i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i njesisë bazë, në rastet kur ky i fundit nuk është prezent, teza miratohet nga dekani i fakultetit. Në përfundim të vlerësimit studentit njihet me rezultatin.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmblyëse.</p>	<p>GVJ konstatoi nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, se institucioni përdor metoda të efektshme të vlerësimit të dijeve të studentëve, për realizimin e qëllimeve dhe objektivave, me fokus parësor aftësimin e tyre.</p> <p>Kontrolli i njohurive të studentëve sipas rregullores së institucionit (<u>Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf</u>) realizohet nëpërmjet: angazhimit në diskutime gjatë leksioneve e seminareve, por edhe në formë kolegiumesh dhe detyrash të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; detyrave të kursit që lidhen me problematikën e disiplinës; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara përgjatë zhvillimit të lëndës si edhe orëve të laboratorit. Sistemi i vlerësimit të studentëve realizohet nëpërmjet vlerësimit nga nota 4 deri në 10, ku nota 5 rezulton si notë kaluese. Kontrolli i dijeve të studentëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara.</p> <p>Mënyra e vlerësimit dhe kriteret i bëhen me dije studentëve, që në fillim të vitit akademik dhe janë pjesë përbërëse e syllabuseve të lëndëve.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Bazuar në RVB si edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me procedurën e organizimit të provimit përfundimtar.</p> <p>Kështu konkretisht, gjatë përgatitjes së procesit të zhvillimit të provimit përfundimtar, Departamenti, duke u bazuar në rregulloren e programit të studimit Elektro Mekanikë, shqyrtojnëme kujdes natyrën e këtij programi, planet mësimore dhe syllabuset më të përshtatshme (<u>Evidenca 50 Programi dhe modelet teze PPP.pdf</u>). Ky proces i rëndësishëm zhvillohet për të evidentuar saktësisht kategorinë e lëndëve themelore që duhet të përmbajë provimi përfundimtar, të cilat i përshtatet më shumë profilit të programit të studimit. Më tej në bashkëpunim me stafin akademik, i cili është përgjegjës për mbulimin e këtyre lëndëve, hartojnë dhe miratojnë përmbajtjen e testit. Provimi përfundimtar është i ndërtuar nga 6 sesione pyetje përkatësisht për 6 lëndë të ndryshme. Rëndësia dhe peshë e secilës lëndë në provimin përfundimtar përcaktohet me bazë përqindjeje dhe total pikësh të shpërndara për çdo pyetje, respektivisht për secilën lëndë, të cilat</p>

	ndërmerren dhe komunikohen nga Departamenti. (5. Raporti vlersimit te brendeshm.pdf)
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në përfundim të përbushjes së detyrimeve kurrikulare studentët e këtij programi studimi nuk përgatisin një temë diplome por zhvillojnë një testim përmbyllës, i cili ka si funksion vlerësimin e dijeve të marra nga studentët. Kjo zgjedhje është bërë për faktin se mesatarja në hyrje e studentëve është e ulët dhe dijet e tyre nuk cilësohen të mjaftueshme për hartimin e një teme diplome. Për këtë arsye për t'u ardhur në ndihmë zhvillohet ky lloj testimi (Evidenca 50 Programi dhe modelet teze PPP.pdf).
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Në përfundim të përbushjes së detyrimeve kurrikulare studentët e këtij programi studimi nuk përgatisin një temë diplome por zhvillojnë një provim përmbyllës dhe pwr kwtearsye nuk ka nevojë për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij.
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	<p>Provimi përfundimtar ose projekti i diplomës vlerësohet me notë, nga komisioni i provimit ose i mbrojtjes së diplomës (Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf, kreu IV).</p> <p>Vlerësimi përfundimtar është një mesatare e vlerësimeve të pavarura të anëtarëve të komisionit pas prezantimit të temës nga kandidatit dhe pas përgjigjeve të pyetjeve të ngritura nga komisioni. Nota i komunikohet studentit në prani të komisionit nga kryetari i tij.</p> <p>Në rastin e provimit përfundimtar, nota del pas vlerësimit të çdo tematike nga anëtari i komisionit përgjegjës për grup-pyetje brenda fushës së tij të ekspertizës.</p>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Në përfundim të studimeve, pasi studenti plotëson të gjitha kërkesat e procedurës së diplomimit, duke përfshirë 120 kredite ECTS, zyrat administrative përkatëse përfundojnë procedurën zyrtare të diplomimit për studentin. Sekretaria mësimore pajis studentët e diplomuar me diplomën “Diplomë Profesionale” sipas formateve të aprovuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Për diplomat profesionale 2 vjecare nuk parashikohet lëshimi i suplementit të diplomës. Studentët pajisen përkatësisht me numër matrikulli nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Pas përfundimit të studimeve, studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar.</p> <p>Diploma lëshohet vetëm një herë, dhe regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Emërtimi i fushës së arsimit të kryer përcaktohet në vendimet përkatëse të licencimit/akreditimit të secilit program studimi. (Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf, neni 55).</p>



<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>KPT, përveç sistemit elektronik në përdorim nga sekretaria mësimore (<u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u>), në funksion të qëllimit të saj administrativ, ruan dhe plotëson dokumentacionin themeltar të kërkuar nga kuadri ligjor në fuqi. Në veçanti, institucioni plotëson dhe ruan tre regjistra kryesor me të dhëna të plota të studentëve tëregjistruar (<u>Evidenca 45 Regjistri baze, themeltar.pdf</u>), arritjet e tyre akademike (<u>Evidenca 45.1 Regjistri i arritjeve akademike.pdf</u>) dhe lëshimit të diplomave dhe certifikatave (<u>Evidenca 45.2 Regjistri i diplomave.pdf</u>)</p> <p>Regjistrat e më sipërm, janë sipas formatit të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe plotësimi i tyre realizohet në përputhje të udhëzimeve përkatëse të detajuar nga po kjo ministri.</p> <p>Institucioni ka detyrimin ligjor, që në përfundim të kohës së parashikuar të mbajtjes së këtyre regjistrave pranë institucionit, ti depozitojë ato pranë arkivave të shtetit, duke mbajtur pranë institucionit, një kopje të njehsuar me origjinalin. Nga ku mund të nxirret çdo informacion i nevojshëm për studentët që kanë frekuentuar këtë institucion.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka përcaktuar qartë rregulloret për diplomimin e studentëve (me provim përfundimtar), përfshirë këtu edhe mënyrën e vlerësimit.</i></p> <p><i>Institucioni mban dhe pajis studentët me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, duke përfshirë diplomën sipas formatit të miratuar dhe me numër unik, regjistrat themeltar, atë të avancimit akademik dhe atë të diplomimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe u komunikua se synohet më tepër mësimdhënie në mënyrë interaktive duke aktivizuar edhe studentët gjatë leksioneve. Seminaret zhvillohen duke trajtuar përveç aspekteve teorike, raste studimesh, video etj. Sipas opinionit të stafit akademik, duke ditur edhe nivelin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi, rezulton se kjo mund të jetë mënyra më e mire për mësimdhënien. Në vazhdimësi personeli akademik i institucionit si dhe ai qëwshtëi angazhuar nëkwtëprogram studimi, kualifikohen brenda institucionit dhe jashtë tij në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve me institucione të</p>

	<p>tjera homologe permes tryezave të rrumbullakëta, diskutimeve, leksioneve të hapura, apo mobilitete të stafit.</p> <p>Këto aktivitete kanë shërbyer si trajnime për stafin akademik dhe përmirësimin e aftësive të mësimit dhe përshtatjes së metodave të reja në të.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimit dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>Institucioni ka ngritur struktura në nivel institucional dhe fakulteti për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimit dhe mësimit. Departamentet, dorëzojnë në Rektorat çdo fund viti akademik, një raport vjetor, i konceptuar si një model i vlerësimit të brendshëm të njësisë. Ky raport shërben për të patur një pasqyrë të fakultetit dhe për t'u përmirësuar në vazhdimësi.</p> <p>Në nivel institucional, për monitorimin e procesit të mësimit dhe mësimit një funksion të rëndësishëm ka dhe "Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë" e cila ndër detyrat e shumta që mban, ka si detyrë edhe monitorimin e procesit mësimit dhe mbledhjen e të dhënave të studentëve mbi procesin e mësimit dhe mësimit. Kjo njësi analizon të dhënat e mbledhura dhe i shpërndan ato tek përgjegjësi përkatës i njësisë bazë (Evidenca 13.2 Raporti NJSBC.pdf, Evidenca 15 Formularet e vlerësimit studente.pdf, Evidenca 16 Focus grupe.pdf)</p> <p>Më pas drejtuesi i njësisë bazë ka për detyrim të shpërndaj informacionin e marrë nga pyetësorët dhe ta diskutoj atë me lektorin përkatës. Rezultatet i bashkëngjiten dosjen së personelit akademik të mbajtur nga Zyra e Burimeve Njerëzore (Evidenca 29.1 Dosja e personelit.pdf).</p> <p>Gjithashtu kjo NJSBC ka një rol të rëndësishëm në analizimin e ndryshimeve ligjore dhe përshtatjen e tyre me planet mësimore të ofruara nga institucioni. Planet mësimore për hapjen e programeve të reja, apo për ndryshimet në programet ekzistuese kontrollohen nga NJSBC për pjesën ligjore dhe për përshtatjen e tyre me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Gjatë takimit me NJSBC u vu në dukje se kjo njësi nuk ndërhyr në cilësinë apo në planifikimin e planit mësimit, pasi kjo është kompetencë e plotë e njësisë bazë.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimit bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC harton një plan vjetor të përvitshëm, ku parashikon të gjitha proceset e kontrollit dhe vlerësimit. Më pas harton raportet me gjetjet përkatëse. Gjithashtu NJSBC informon në mënyrë periodike rektoratin, drejtuesit e fakulteteve, përmes tyre në mënyrë konfidenciale të gjithë stafin akademik rreth rezultateve të anketimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p> <p>(Evidenca 13.2 Raporti NJSBC.pdf, Evidenca 15 Formularet e vlerësimit studente.pdf, Evidenca 16 Focus grupe.pdf)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon</p>	<p>Pjesë e Planit Strategjik (Evidenca 7 Strategjia 2021 -2025 kerkimi i tregut.pdf), ndër të tjera është zhvillimi, trajnimi dhe kualifikimi I vazhdueshëm I stafit, si në aspektin e mësimit dhe mësimit ashtu edhe në</p>

shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	aspektin e kërkimit shkencor. Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe në kuadër të projekteve Erasmus, organizon mobilitete të stafit akademik për mësimdhënie ashtu sikurse edhe për trajnime. (Evidenca 6.2 Veprimtari te stafit ne kuader te projekteve trajnimeve.pdf)
---	---

Konkluzione	<i>Personeli akademik i institucionit si dhe ai që është angazhuar në këtë program studimi, kualifikohen brenda institucionit dhe jashtë tij. Institucioni ka ngritur struktura në nivel institucional dhe fakulteti për të promovuar dhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.</i>
--------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me përgjegjësin e Departamentit të Elektro Mekanikes dhe Sistemeve të Aplikuara përgjegjës për programin profesional në “Elektro Mekanike” u vendos theksi që, Kolegji Profesional I Tiranës (KPT). ndjek një politikë të qartë në drejtim të rekrutimit të stafit akademik. Synim i së cilës është tërheqja e stafit të kualifikuar me grada e tituj shkencor (mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një eksperiencë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre, janë unikë në fushën e tyre të specializimit), me eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe rekrutimi i stafit administrativ me eksperiencë për pozicionin vakant.</p> <p>Evidenca 29 Manuali i burimeve njerezore.pdf</p> <p>Lidhur me programin 2-vjecar profesional në Elektro Mekanike, përpos kërkesave sipas akteve nënligjore e kriterëve të përgjithshme që KPT zbaton për rekrutimin, stafi duhet të ketë minimalisht kualifikimin, MSc. kryesisht në fushën Inxhinieri Mekanike, Energjitikë, Elektrike etj. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i kushtohet punësimit të ekspertëve/profesionistëve me përvojë konkrete e që janë të angazhuar në kompani të ndryshme që operojnë në fushën e mekanikes, elektro-mekanikes, mekatronikes etj. Finalizimi I procedurës së punësimit përmbillet më kontratën e punës ku evidentohen element të ngarkesës mësimore, detyrimeve dhe përgjegjësive etj.</p> <p>Evidenca 29.2 Kontrata tip e punes.pdf</p> <p>Departamenti i Elektro Mekanikes dhe Sistemeve të Aplikuara ka për vitin akademik 2022-2023 ka në strukturën e tij: Staf akademik efektiv 11 anëtarë, nga të cilët: 2 me titullin Prof. Dr. dhe 9 me gradën Msc.</p> <p>Evidenca: <u>Documents 3. Kolegji Profesional i Tiranës, verifikim i Stafit Akademik, datë 12.10.2022.docx</u></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga takimi I GVJ me Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe me stafin efektiv të KPT për programin profesional në “Elektro Mekanike” ngarkesa mësimore percaktohet në kontratën individuale të punës. Kjo ngarkesë percaktohet me vendim Rektorati dhe është në përputhje me kriteret e akteve nënligjore në fuqi. Personeli akademik efektiv u shpreh gjithashtu që krahas ngarkesës në auditor është i angazhuar</p>

	<p>edhe me veprimtari të tjera mbështetëse si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • tutoriati, • këshillim akademik, • praktikat profesionale etj, <p><u>Evidenca 29.2 Kontrata tip e punes.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 29.3 Vendimi rektoratit per percaktimin e ngarkeses mesimore per stafin efektiv.pdf</u></p> <p><u>Evidence shtese Lista e stafit akademik efektiv 5 vite.pdf</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga dokumentat e vendosura sistemi evidentohet qëKPT paguan rregullisht detyrimet në lidhje me kontributet shëndetësore, shoqërore dhe tatimore në përputhje me aktet rregullatore në fuqi.</p> <p><u>Evidenca 32 Detyrimet ne kohe reale - pagesa e kontributeve.pdf</u></p> <p>Periudha nga “Vendim Për akreditimin e parë të programit të studimit 2 vjeçar me karakter profesionalnë “Elektro-Mekanikë”, të “Kolegjit Profesional të Tiranës” Nr. 81 date 21.09.2017” dhe deri ne kwrkeswn per kwtëakreditim tëdyte tregon pwr njëqwndrueshmwri tëstafit akademik tëbrwndwshwm dhe administrativ tëKPT-sw. <u>Evidence shtese Lista e stafit akademik efektiv 5 vite.pdf</u></p> <p>Nga takimi I GVJ me Zyrës së Burimeve Njerëzore, personeli I KPT-sëmund tëjetël i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar si dhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Nëtëgjitha rastet KPT lidh kontratën përkatëse të punës e cila bazohet në legjislacionin në fuqi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve. <u>Evidenca 29.2 Kontrata tip e punes.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në vizitën që GVJ pati në institucion, stafi i burimeve njerëzore shprehet se vendet vakante për personel akademik apo administrativ bëhen publike në faqen web të institucionit https://kolegji-profesional.edu.al/punesimi-ne-kpt/. Sipas tyre, ndër kandidatët për personel akademik efektiv apo të ftuar, përzgjidhen më të mirët, duke synuar jo thjesht formimin akademik por mbi të gjitha profesionalizmin, ekspertizën dhe eksperiencën në fushat përkatëse ku ata edhe do të angazhohen në mësimdhënie.</p> <p>Çdo Departament përcakton nevojwn per staf akademik ne funksion tëngarkesws dhe tëplane mwsimore tëlwndwve. Njwsia bazëpwrçakton kriteret e punwsimit tëcilat miratohen nga Rektori. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me konkurs nga njëkomision rekrutimi në bazë pwr bushjes sëkriterëve tëshpallura.</p> <p><u>Evidence shtese Procedure rekrutimi.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e</p>	<p>Mbeshtetur në dokumentat bazë të KPT (statuti, rregullore, etj..) personeli ndihmës akademik/laboratorik përzgjidhet me konkurs nga nje Komision Vlersimi të kandidatëve mbështetur në kriteret e shpallura dhe të vendosura nga departamenti. <u>Evidence 3. Statuti.pdf</u></p> <p>Nga vizita qëGVJ zhvilloi nëmjediset e laboratet e KPT pwr programin profesional “Elektro Mekanikë” personat pwr gjegjws</p>

mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	paraqesnin formim profesional me pwrvojëtëgjatw, ekspertë të fushës dhe të suksesshëm në profesionin e tyre.			
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	Nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, nga kontrolli i dokumentacionit në dosjet e personelit akademik dhe administrativë të KPT-së u evidentua që dosja përmbante në mënyrë të përditësuar sa më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dokument identifikimi; ▪ CV-në (sipas formatit të BE-së); ▪ Raport i aftësisë për punë/Librezë shëndetësore; ▪ Librezë Pune dhe Librezë Kontributesh për Sigurimin Shoqëror dhe Shëndetësor (nëse ka); ▪ Leje nga Punëdhënësi kryesor (Vetëm në rastet kur personeli akademik është I angazhuar me kohë të pjesshme në KPT dhe full time në një IAL tjetër) ▪ Diplomë të arsimit të lartë të kryer ▪ Etj. 			
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Mbështetur në rregulloren e programit të studimit <u>Evidenca 3 Statuti.pdf</u> dhe planit mësimor <u>Evidenca 5.3 Plani mesimor.pdf</u> programi i studimit permbillet me praktike mësimore 10ECTS total. Staf i akademik krahas ngarkesës mesimore zhvillon sistemin e tutorazhit dhe mbikëqyrjes studentore pwr zhvillimin e praktikës mësimore pranë subjekteve apo bizneseve. Këto praktika rregullohen në bazë të marrëveshjeve institucionale ndërmjet KPT dhe bizneseve ku në <u>Evidenca 33 Lista e partnereve, Marreveshjeve te bashkepunimit.pdf</u> jepen disa korrespondenca dhe foto nga aktivitetet promovuese te bashkëpunimit me bizneset.			
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Nga takimi që GVJ zhvilloi ne institucion dhe dokumenta e vena ne dispozicion dosja e praktikës profesionale pjesë të sajën ka edhe procesin e vlerësimit nga personeli mbikëqyrës gjatë kryerjes së praktikës <u>Evidenca 5.4 Dosja e praktikës.pdf</u> . Institucioni/subjekti i angazhuar mbështet studentët për kryerjen me profesionalizëm të praktikës profesionale gjatë gjithë periudhës së sajë dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të studentit.			
Konkluzione	<i>Kolegji Profesional i Tiranës bën përpjekje të vazhdueshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, trajnimin e stafit akademik dhe ndihmes akademik duke përzgjedhur ekspert të fushës në përshtatje me natyrën e lëndëve që programi i studimit ofron.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi			
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konstatoi që mjediset (labororët dhe klasat për mësimdhënien) garantojnë zhvillimin normal të veprimtarive mësimore. Mjediset nga pikpamja infrastrukturore dhe arkitektonike sigurojnë mësim normal me standarte në drejtim të ndriçimit, lartësisë, kushteve të sigurisë në përpunime me numrin e studentëve të programit profesional në Elektro-Mekanik. <u>Evidenca 34 Infrastruktura.pdf</u></p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, labororë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë (<u>Evidenca 34 Infrastruktura.pdf</u>).</p> <p>GVJ konstatoi sëtëgjitha mjediset e detikuara për mësimdhënien janë të pajisura me infrastrukturë audio-vizive, internet dhe pajisje të tjera të nevojshme në ndihmë të procesit mësimor. Labororet në dispozicioni të këtij programi janë 9 Labororë/oficina <u>Evidenca 22 Labororet.pdf</u>, me natyrë ndërdisiplinore.</p>			
<p>Kriteri 3. Labororët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sallat e leksioneve dhe seminareve për këtë program studimi janë të pajisura me kompjuter dhe vidioprojektor, si edhe me tabela për të mundësuar një proces mësimdhënies efektiv.</p> <p>Labororët që institucioni disponon dhe që përdoren edhe për këtë program studimi, janë të pajisura me pajisjet e duhura harduerike dhe softuerike që studentëve ju nevojiten (<u>Evidenca 22 Labororet.pdf</u>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ evidentoi se Kolegji Profesional i Tiranës ka në dispozicion të programit të studimit 4 labororë të teknologjisë së informacionit me 25 poste pune të pajisur me programe profesionale të tilla si: Autocad, Fusion360, Arduino IDE, LogoSoft (Programim PLC), Raptor, TinaSoft, Multisim, Word /Excel/PowerPoint, Paketa Office365 etj (<u>Evidenca 34.1 Infrastruktura IT.pdf</u>)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, në dokumentacionin (Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekes.pdf) e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore.</p> <p>Gjithashtu në çdo syllabus të secilës prej lëndëve përcaktohet literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar, në gjuhën shqipe dhe/ose Anglisht, në raste të caktuara Evidenca 5.5 Syllabus.pdf.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, Institucioni vë në dispozicion të studentëve pa pagesë bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët. Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekes.pdf, Evidenca 34.3 Karta e bibliotekes.pdf</p> <p>Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur. Biblioteka disponon vende të mjaftueshme për studentët dhe u ofron atyre mundësinë për të studjuar, për të përdorur literaturën mësimore bazë apo ndihmëse duke përdorur kompjuterat që biblioteka disponon si edhe bibliotekën online Evidenca 34.4 Biblioteka online.pdf.</p>
<p>Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ u informua se biblioteka e institucionit ka tituj në gjuhën shqipe, tituj në gjuhë të huaj si edhe materiale periodikë.</p> <p>Të gjithë titujt e bibliotekës përditësohen rregullisht në databazën e Bibliotekës dhe çdokush, në çdo kohë mund të ketë akses tek titujt që janë gjendje (https://kolegjiprofesional.edu.al/online-library-oer/)</p> <p>Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera, disa prej të cilëve janë të lidhur me bibliotekën online. Evidenca 34.4 Biblioteka online.pdf.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të</p>	<p>Institucioni ka akses në bibliotekën digjitale. KPT ofron libraritë e sugjeruara on-line nga biblioteka ku institucioni është abonuar apo që janë me akses të lirë si openlibrary.org, link të mundësuar nga Biblioteka Kombëtare, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivës së</p>

studimit.	<p>Shtetit etj</p> <p>Biblioteka dixhitale ofron një mori artikuj të revistave akademike, libra si edhe dokumente në një sërë disiplinash. Biblioteka online është e aksesueshme falas nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p><u>Evidenca 34.4 Bibloteka online.pdf.</u></p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka e institucionit ndër të tjera, është e pajisur secila me kompjutera të cilët kanë akses dhe në internet duke mundësuar në këtë mënyrë dhe aksesimin në bibliotekat online te të cilat institucioni ka abonime.</p> <p><u>Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekes.pdf, Evidenca 34.3 Karta e bibliotekes.pdf</u></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka funksionon nga e hëna në të premte gjatë gjithë vitit akademik si edhe gjatë sezonit të provimeve duke ofruar shërbimet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Huazim i librave/teksteve. Studentët mund të regjistrohen duke paraqitur një vërtetim studenti, fotokopje të kartës së identitetit dhe një foto; - Sallë studimi; - Hapësirë për kryerjen e detyrave apo projekteve në grup. <p>Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëna-Premte 9:00- 20:00 e Shtunë 9:00-17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur.</p> <p><u>Evidenca 34.2 Rregullorja e bibliotekes.pdf, Evidenca 34.3 Karta e bibliotekes.pdf</u></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u informua se shtimi i zërave të bibliotekës bëhet mbi bazën e kërkesave të bëra nga Departamentet duke u bazuar në buxhetin e institucionit. Gjithashtu, Institucioni, ka pasuruar edhe bibliotekën online duke qenë pjesë e një sërë platformave online.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Biblioteka e institucionit ka tituj në gjuhën shqipe, tituj në gjuhë të huaj si edhe materiale periodikë. Biblioteka dixhitale ofron një mori artikuj të revistave akademike, libra si edhe dokumente në një sërë disiplinash. Biblioteka online është e aksesueshme falas nga studentët dhe stafi akademik.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p style="text-align: center;">Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit		kryesisht	plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.</p>	<p>Menaxhimi i informacionit që lidhet me aktivitetin e studentit në Kolegjin Profesional të Tiranës garantohet nga Rregulloret përkatëse. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që mbahet nga kjo Sekretari dhe që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me mbajtjen në format letër Regjistrin të arritjeve akademike dhe Regjistrin të diplomave si dhe me dokumentacionin e dorëzuar nga studenti në momentin e regjistrimit/transferimit. Regjistri themeltar gjithashtu mbahej në format elektronik ashtu edhe në formë fizike në regjistrin e miratuar nga QSHA.</p> <p>Gjithashtu, aplikacionet në nivel institucioni janë të vendosura në Classter i cili përfshin gjithë modulet e sistemit të menaxhimit të informacionit të Studentëve. Sistemi mundëson komunikimin e informacionit si: mësimin, orari i sezoneve të provimit, rezultatet e mbledhjet e punës.</p> <p>Sekretaria mësimore nëpërmjet kwtij sistemi, administron të gjithë informacionin e studentit nga regjistrimi i tij e deri në përfundim të studimeve, për detyrimet e lëndëve, vlerësimin etj.</p> <p><u>Evidenca 28 Manuali Classter.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>GVJ, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion sikurse edhe nga takimi që pati në institucion, evidentoi se Institucioni mban të dhënë të cilat rinovohen çdo vit në lidhje me stafin akademik, ndihmës akademik sikurse edhe atë administrativ apo edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që Institucioni ka me partner të ndryshëm për mbarëvajtjen e programit të studimit. Dosjet fizike të Personelit mbahen në Zyrën e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Gjithashtu në faqen zyrtare ueb të Institucionit prezantohet i gjithë aktiviteti i kryer prej stafit akademik, ndihmës akademik, studentët sikurse edhe bashkëpunimet që institucioni ka me partner të ndryshëm. https://kolegji-profesional.edu.al/</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në</p>	<p>Studentët që në momentin e regjistrimit në një program studimi, pajiset me adresë email-i personale me anë të të cilës komunikojnë në</p>


<p>informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>vazhdimësi për çdo gjë me stafin akademik të programit, stafin administrative etj. Gjithashtu stafi akademik i programit të studimit, komunikon me studentët nëpërmjet adresave të emailit të tyre por gjithashtu edhe nëpërmjet platformave të ndryshme si p.sh.. Teams, për hedhjen e materiale apo leksioneve të ndryshme. <u>Evidenca 25 Mesimi Online Zyra IT Video Tutorial Manual Komunikime.pdf</u></p> <p>Gjithashtu nëpërmjet sistemit të menaxhimit Classter pedagogu mund të mundësojë studenteve materiale si literaturën, syllabuse, ushtrime etj. <u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Për të mundësuar komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, institucioni gjithashtu ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike. Nëpërmjet Microsoft Teams si dhe Classter janë zhvilluar seanca mësimore gjatë pandemisë (mësim online), ndërsa me rikthimin në auditor, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektsh, njoftime, informacione etj. Gjithashtu gjithë stafi dhe studentët e institucionit janë të pajisur me adresa email-i zyrtare duke u përdorur edhe kjo formë komunikimi nga pedagogët dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><u>Evidenca 28 Manuali Classter.pdf</u></p> <p><u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Gjithashtu, në dispozicion është sistemi Classter, faqet zyrtare të institucionit, ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p><u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u></p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të KPT, të cilat rezultojnë të përditësuara. Gjenden informacione të detajuara lidhur me planin mësimor të programit të studimit. Në faqen e KPT jepet informacion dhe për kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional, etj.</p> <p>GVJ eksploroji mundësitë e ofruara për përfitim të informacionit dhe është i mendimit se informacioni i paraqitur është me interes si për studentët ashtu dhe për kandidatët për studentë.</p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/programet-e-studimit-ne-kpt/</p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifate-studimit-dhe-bursat/</p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/kurse-profesionale/</p>

Konkluzione	<p><i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore.</i></p> <p><i>Informacioni në lidhje me stafin akademik PAE, PAK dhe ndihmës akademik mbahet nga Zyra e burimeve njerëzore.</i></p> <p><i>Të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me programet e studimit, personelin akademik si dhe aktivitete të ndryshme merren nëpërmjet faqes elektronike të KPT, të cilat rezultojnë të përditësuara.</i></p> <p><i>Të dhënat për të gjithë studentët menaxhohen në sistemin Classter.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>KPT raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore.</p> <p>KPT është institucion i arsimit të lartë privat me vetëfinancim. Burimet financiare, përfshijnë tarifën e shkollimit, projekte / grante ndërkombëtare të KPT, financimi nga ortakët e KPT shpk në cilësinë e pronarit, të ardhura nga shërbimet që KPT ofron për të tretë, burime të tjera të ligjshme. Tarifat janë të publikuara rregullisht në faqen zyrtare të internetit të KPT për çdo vit akademik (https://kolegijiprofesional.edu.al/tarifate-studimit-dhe-bursat/).</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat. Për shkak të përmasave të institucionit, por edhe faktit që infrastruktura por edhe stafi angazhohet në programe të ndryshme është praktikisht e pamundur të hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Nga analiza edhe e rregulloreve të brendshme, vihet re një procedurë e konsoliduar e hartimit të nevojave të brendshme të institucionit të cilat më pas reflektohen edhe në planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim</p>	<p>Sipas RVB, pasqyrat financiare auditohen cdo vit nga një palë e tretë e</p>

periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	pavarur. IAL është transparent në lidhje me shlyerjen e detyrimeve financiare përkundrejt palëve të treta, si dhe deri tani ka treguar qëndrueshmëri financiare.		
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Bazuar në RVB, raportet hartohen në bazë institucioni dhe nuk janë të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.		
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	KPT shqyrton dhe analizon në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. KPT llogarit koston për të gjithë institucionin, ashtu si dhe për programet e vecanta: metodologjia ka për bazë llogaritjen me bazën standarte të shpenzimeve në total / shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament. IAL deri tani ka treguar qëndrueshmëri financiare.		
Konkluzione	<i>KPT dhe vetë programi i studimit paraqet qëndrueshmëri financiare. Dokumentacioni dhe takimet e kryera i mundësuan GVJ të konkludojë në ekzistencën e garancisë së stabilitetit financiar të këtij programi studimi, ndonëse në raportet financiare nuk jepet impakti financiar i ndarë sipas programeve të studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se për programin e studimit “Elektro Mekanikë”, pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e njvsisëbazë kryesore, zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p>Evidenca 3 Statuti.pdf</p> <p>Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf</p> <p>Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për cdo student. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit.</p> <p>Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Shpallja e fituesve për këtë program studim bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të KPT. Pranë Kolegjit Profesional të Tiranës, kanë të drejtë të aplikojnë dhe regjistrohen të gjithë kandidatët të cilët kanë një notë mesatare nga matura shtetërore poshtë notës 6.5. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë, në programin e studimit “Elektro Mekanikë” për vitin akademik 2022-2023 ” është 13 studentë.</p> <p>Evidenca 3 Statuti.pdf</p> <p>Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf</p> <p>Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas</p>	<p>Çdo fillim viti akademik, njësia bazë, pwrgegjwse pwr programin e studimit “Elektro Mekanikë”, propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të KPT.</p> <p>Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në programin e studimit “Elektro Mekanikë”, pedagogët u shprehën se kandidatët e interesuar mund të gjejnë informacion në lidhje me to në faqen e ueb të</p>

<p>ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>institucionit, duke kontaktuar me Zyrën e këshillimit të karrierës apo edhe në ditët e hapura të informimit që organizohen nga institucionet e arsimit universitar.</p> <p>Në dosjen e programit të studimit në fjalë paraqiten në mënyrë të detajuar, studentët potencialë, objektivat e formimit si edhe punësimi i mundshëm i tyre.</p> <p><u>Evidenca 23 Vendimet SA (per kuotat e pranimit per cdo vit akademik).pdf</u></p> <p><u>Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf</u></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik</p> <p><u>(Evidenca 23 Vendimet SA (per kuotat e pranimit per cdo vit akademik).pdf)</u></p> <p>Kriteret e pranimit bëhen publike në faqen e internetit të KPT. (https://kolegjiprofesional.edu.al, <u>Evidenca 24 Politika e komunikimit.pdf</u>)</p> <p>Elementë më të detajuar lidhur me pranimin e studentëve jepen në Rregulloren e programit të studimit (<u>Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf</u>).</p> <p>Gjithashtu KPT organizon aktivitetet e tilla si turet nëpër shkollat e mesme (<u>Evidenca 24.1 Turet.pdf</u>), për të informuar çdo maturant mbi programet e studimit që KPT ofron, kushtet dhe kriteret e pranimit etj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>KPT ndjek politika të mbështetje së kategorive sociale të veçanta. Kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve nga këto kategori bëhen publike para fillimit të vitit akademik në faqen ueb të institucionit.</p> <p>Pranimi i studentëve bazohet në aktet e brendshme rregullatore, duke përcaktuar kriteret e veçanta për pranimin në vartësi të programit specifik të studimit.</p> <p><u>Evidenca 3 Statuti.pdf</u></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>KPT ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në KPT. Gjithashtu institucioni ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët.</p> <p>https://kolegjiprofesional.edu.al/tarifatestudimitdhebursat/ .</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion GVJ konstatoi se për programin e studimit “Elektro Mekanikë”, pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e KPT, Rregulloren e KPT dhe Rregulloren e programit të studimit.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Programi i studimit “Elektro Mekanikë” realizohet me 120 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja akademike është 2 vjet. Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite (60 vitin e parë dhe 60 vitin e dytë). Studimet e këtij programi përmbillen me provim përfundimtar (<u>Evidenca 5.3 Plani mesimor.pdf</u>). Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të KPT. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullorja e programit të studimit “Elektro Mekanikë” <u>Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf</u> - Rregullore e Kolegjit Profesional tëTiranws; <u>Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf</u>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Neni 44, pika 3.h i Statutit të KPT (<u>Evidenca 3 Statuti.pdf</u>) jep elementët që lidhen me transferimet dhe kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Studentët apo kandidatët për studentë në këtë program studimi mund të njihen me këta elementë duke aksesuar edhe nëpërmjet linkut:</p> <p>https://kolegjiiprofesional.edu.al/</p> <p>Gjithashtu GVJ, e konfirmoi kwtëprocedurëedhe gjatëvizitws në Sekretarinë Mësimore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informacioni në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit përftohet nëpërmjet rregullores së programit të studimit (<u>Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf</u>) si edhe syllabuseve tëlwndwve (<u>Evidenca 5.5 Syllabus.pdf</u>).</p> <p>GVJ u informua se elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të</p>

	lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.		
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e institucionit (<u>Evidenca 4 Rregullorja KPT.pdf</u>) dhe bazën ligjore të institucionit janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. Mbrojtja e diplomës është detyrimi përfundimtar për diplomimin e studentit. Mbrojtja bëhet përmes paraqitjes së një punimi diplome ose dhënies së një Provimi të Përgjithshëm Përfundimtar, sipas vendimit të Rektorit për cdo vit akademik. Pwr programin e studimit “Elektro Mekanikë” shlyerja e detyrimit pwrfundimtar, bwhet nwpwrmet Provimit pwrfundimtar i cili ka 7 (shtatw) kredite (<u>Evidenca 5 Rregullorja e programit te studimit.pdf</u> ; <u>Evidenca 5.3 Plani mesimor.pdf</u>)		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ u informua se institucioni, në fillim të çdo viti akademik, periodikisht përpara se studentët të përzgjedhin programet e tyre të studimit organizon takime të hapura informimi me ta, nëpërmjet zyrës së shërbimit ndaj studentëve e cila bashkëpunon me njësisë bazë përgjegjëse për secilin nga programet e studimit. Gjithashtu faqja e internetit e KPT (https://kolegjiprofesional.edu.al/) ofron një gamë të gjerë informacionesh në lidhje me kushtet e pranimit në programin e studimit, objektivat dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit, skemën e vlerësimit, mundësinë për studime të mëtejshme, mundësitë e punësimit dhe të kualifikimit profesional dhe planin mësimor të programit të studimit.		
Konkluzione	<i>Studentët e programit të studimit njihen me strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit nëpërmjet informacioneve në faqen së internetit të KPT. Elementë më të detajuar lidhur me planin mësimor, kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin gjenden në rregulloret përkatëse.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet nështet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e	GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në

	fuqimisht orientimi i studentëve drejt dhe në tregun e punës.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Elementë të tjerë si orari i mësimave, struktura e vitit akademik, datat e provimeve apo datat e shlyerjeve të detyrimeve, aksesohen gjithashtu edhe nëpërmjet faqes së internetit të institucionit si edhe nëpërmjet sistemit <u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u>. Po ashtu, nëpërmjet faqes së internetit mund të përftohen edhe njoftime për tarifat e studimit etj.</p> <p>Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Sekretaria Mësimore. Gjithashtu nëjavwn e parëtëfillimit tëcdo viti akademik, institucioni organizon Javwn e orientimit, gjatësëcilws studentwt orientohen dhe informohen pwr gjithcka qëlidhet me programin e studimit, procesim mwsimore, infrastrukturwn etj (<u>Evidenca 30 Java e orientimit.pdf</u>). GVJ e gjen një praktikë të tillë në përputhje me standardin.</p>			
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se, Institucioni nëpërmjet përgjegjësit të departamentit si edhe pedagogut mbikqyrës për praktikën profesionale vë në dijeni studentët në lidhje me programin e praktikës, detyrimet e praktikës, si edhe kohën e zhvillimit të saj dhe kompanitë ku do të zhvillohet praktika. Praktika për kwtëprogram studimi zhvillohet një muaj, në vitin e dytw, semestrin e dytë. Institucioni ka njëswrëmarrwveshjes bashkwpunimi ku studentwt e kwtij ptogrami studimi, mund tëkryejnëpraktikwn profesionale por qëkanëshwrbyer njwherazi edhe si njëmundwsi punwsi pwr kwtu studentë(<u>Evidenca 33 Lista e partnereve, Marveshjeve te bashkepunimit.pdf</u>).</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, praktikwn profesionale, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni mban të dhëna të detajuara për studentët nga hyrja e deri në dalje si edhe të dhëna për studentët e regjistruar, studentët me bursë, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matricullimit . Këto të dhëna për studentët e çdo programi studimi mbahen në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave nëpërmjet Sistemit Classter (<u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u>), dosjes së studentit dhe regjistrin themeltar. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit.</p> <p>Të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin themeltar (regjistri bazë) (<u>Evidenca 45 Regjisti baze, themeltar.pdf</u>) i cili përmban të dhënat e detajuara për programin e studimit, formën e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme, në përputhje me Udhëzimin e MAS si edhe ligjet në fuqi.</p>
<p>Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nëpërmjet Sistemit Classter (<u>Evidenca 28.1 Sistemi Classter.pdf</u>). Për të garantuar sigurinë e informacionit, hyrja realizohet nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Institucioni mban të dhënat në mënyrë manuale në regjistra specifikë, gjithashtu edhe në mënyrë elektronike. Këto të dhëna kontrollohen nga personat e autorizuar dhe ruhen sipas rregulloreve përkatëse në KPT.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti dhe Sekretaria Mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Qendra e Karrierës dhe Alumni analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti, Fakulteti apo Institucioni. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik (<u>Evidenca 36 Raporti vjetor.pdf</u>).</p>
Konkluzione	<i>Statistikat vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga</i>

	<i>programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve mbahen nga Sekretaria Mësimore si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të KPT (<u>Evidenca 3 Statuti.pdf</u>) sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtar me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: - -Senatin Akademik të UMT; - NJBSC
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KPT garanton lirinë e dhënies së mendimeve apo sygjërimeve të studentëve në lidhje me vlerësimin e procesit akademik. Në fund të çdo semestri, në përfundim të çdo lënde, student npr një pyetësori japin mendimet e tyre në lidhje me performancën e çdo pedagogu, për mësimdhënien në leksione, seminare, komunikimin etj (<u>Evidenca 15 Formularet e vlerësimit studente.pdf</u> , <u>Evidenca 16 Focus grupe.pdf</u>). Vlerësimi nga studentët mbetet anonim dhe i gjithë informacioni i dhënë prej tyre është konfidencial.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Marrja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të institucionit (Senat, NJSBC, GVB etj.) (<u>Evidenca 3 Statuti.pdf</u>). Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve si edhe grup fokus merret, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit (<u>Evidenca 15 Formularet e vlerësimit studente.pdf</u> , <u>Evidenca 16 Focus grupe.pdf</u>). Në mënyrë të veçantë përpunimi i të dhënave të pyetësorit të vlerësimit të lëndës nga studenti, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme.
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të	Për sa i përket procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, zbatohen procedurat e përcaktuara në rregulloret përkatëse (<u>Evidenca 5 Rregullorja e programit të studimit.pdf</u> ; <u>Evidenca 4 Rregullorja</u>

<p>vlërësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>KPT.pdf). Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmeria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. GVJ, bazuar në takimet me studentët dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konkludon se studentët kanë të drejtën e rivlerësimit të kontrollit të dijeve të bëra nga stafi akademik dhe të drejtën e ankimimit. GVJ konstatoi në takimin me studentët se ata ishin të mirinformuar në këtë drejtim dhe se kishin patur raste të ballafaqimit me pedagogët për sa i përket vlerësimit, por që nuk kishin arritur deri në fazën e paraqitjes së ankimimit me shkrim. Nga takimi i GVJ me studentët, rezultoi që procedura realizohet në përputhje me rregulloren (Evidenca: Takim me studentët).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>KPT garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, NJSBC, dhe në të gjitha komisionet e organizuara në KPT si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm dhe përgatitjen e RVB.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Standardi V.6</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit dhe shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të KPT. Në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Karrierës dhe studentëve; - Sekretaria mësimore <p>KPT organizon çdo vit, për studentët e rinj, Javën e Orientimit të Studentëve (Evidenca 30 Java e orientimit.pdf). Gjithashtu institucioni i vë në dispozicion studentit, Manualin e Studentit, një përmbledhje me informacion thelbësor për jetën e studentit në KPT (Evidenca 27 Manuali i studentit.pdf). Gjithashtu nrm sistemit Claster (Evidenca 28.1 Sistemi Claster.pdf), studentwt informohen pwr gjithcka nëlidhje me procesin mwsimor, detyrimet dhe afatet e tyre, orarin e mwsimit, si edhe kalendarin e provimeve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të</p>	<p>Për të mundësuar informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me</p>

<p>posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>procesin mësimor dhe programin e studimit, përveç Sekretarisë Mësimore e cila disponon dhe vë në dispozicion të studentëve gjithë informacionin në lidhje me regjistrimin dhe avancimin akademik të tyre, një rol të veçantë luan edhe Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatorët (Evidenca 3 Statuti.pdf)</p> <p>GVJ konstatoi se një mjet i fuqishëm për informimin e studentëve është dhe faqja e internetit e KPT, (https://kolegjiprofesional.edu.al/) si edhe mediat sociale e cila përditësohet rregullisht dhe që nga studentët informohen për një seri elementësh si njoftime për mobilitete, aplikime për bursa, trajnime, internship-e, webinarë, trajnime, leksione të hapur etj.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ u informua për funksionimin në KPT të Zyra e Karrierës, Informacionit dhe Mbështetjes së Studentëve. Ndër aktivitetet të cilat mbulohen nga kjo qendër mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i leksioneve të hapura, - Organizimi i trajnimeve, workshop-eve, Evidenca 21 Trajnime studente.pdf, Evidenca 11.2 MOVET desing thinking workshop.pdf - Organizimi i Panairit të punës Evidenca 18.1 Panairi i punes ne KPT.pdf - Informacion në lidhje me mobilitetet dhe bursat e studimeve jashtë vendit, Evidenca 38 Praktika connected through mobility.pdf - Mundësimi i internship-eve, duke bashkëpunuar ngushtësisht me partnerët; Evidenca 24.1 Turet.pdf, Evidenca 31 Takimi me biznese.pdf - Mundësi Punësimi, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. Evidenca 24.4 Panairit Work and Study, Panairi House of Europe.pdf, Evidenca 44 Thirrje, njoftime punesimi.pdf
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p>	<p>Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, duke shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, synon edhe grumbullimin e informacionit që lidhet me të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe anketimi për gjurmimin e studenteve i organizuar së fundmi për punësimin e studentëve të diplomuar. Sikurse edhe GVJ u vu në dijeni gjatë takimit që pati në institucion, gjurmimi i studentëve të diplomuar në kuadër të programit të studimit është i vështirë, për shkak të emigrimit të tyre si edhe ndryshimit të adresave të emailit, mediave sociale apo numrave të telefonit. Gjithsesi, nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultoi se për periudhën 2018-2021 janë diplomuar 56 studentë, pjesa më e madhe e të cilëve janë të punësuar në profesion, në bizneset e tyre familjare ose në kompani të ndryshme</p>

	brenda ose jashtëvendit. (Evidence shtese Gjurmimi i studenteve EM.pdf)			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se KPT ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të KPT.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Profesional i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Kolegji Profesional i Tiranës ka vënë në dispozicion të programit të studimit me karakter profesional në “Elektro - Mekanikë” infrastrukturën dhe ambientet e nevojshme për zhvillimin korrekt të mësimin, duke mundësuar zhvillimin e mësimdhënies si ndërthurje e njohurive teorike me ato praktike, të cilat zhvillohen në laboratorë dhe ofcina të profilit të studimit.
2. Kolegji Profesional i Tiranës ka bashkëpunime me biznese të ndryshme të profilit, që mundësojnë ofrimin e praktikave profesionale si një element i rëndësishëm i programeve të studimit, një mundësi e mirë për punësimin e mëtejshëm të studentëve, një këshilltar në hartimin e programeve të studimit dhe kurrikulave, si dhe një bashkëpunëtor i mundshëm në kuadër të kërkimit të aplikuar.
3. Kolegji Profesional i Tiranës është angazhuar në një sërë projektsh europiane si: Erasmus + CBHE, Moduli Jean Monnet dhe projekte pilot të mobilitetit në arsimin profesional të mbështetur nga BE, duke rritur mundësitë e shëmbimit të studentëve dhe personelit akademik e administrativ.

Pika të dobta

1. Mungesa e një studimi të përditësuar të tregut të punës. [Standardi I/Kriteri 4]
2. Mungesa e një raporti analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit duke specifikuar qartazi përfitimet për secilin program studimi të ofruar. [Standardi I.2/Kriteri 2, Kriteri 3]
3. Mungesa e një raporti të detajuar vjetor të NjSBC si përmbledhje e fushave të ndryshme të veprimtimit të Institucionit, në përputhje me standardet e cilësisë. [Standardi I.3/Kriteri 3]

Rekomandime

1. Hartimi i një studimi tregu 3 – 5 vjeçar për këtë program studimi.
2. Hartimi i përvitshëm i një raport analitik të mirëfilltë të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit.
3. Hartimi i një raporti të detajuar vjetor të NjSBC si përmbledhje e fushave të ndryshme të veprimtimit të Institucionit, në përputhje me standardet e cilësisë.
4. Rishikimi i ndarjes së veprimtarive sipas komponentëve mësimore C, D dhe E në përputhje me VKM Nr. 185, datë 25.03.2021.

Evaluation's conclusions for the professional study program "Electro-Mechanics" provided by the Higher Education Institution "Professional College of Tirana"

Strengths and affirmations



1. The Professional College of Tirana has made available for the professional study program in "Electro-Mechanics" the infrastructure and facilities necessary for the correct development of the teaching activities, enabling the development as a combination of theoretical and practical knowledge, which are developed in laboratories and services following the profile of the program of study.
2. The Professional College of Tirana has collaborations with various businesses within the profile of the program of study, which enable the provision of professional practices as an important element of the study programs, a good opportunity for further employment of students, an advisor in the design of study programs and curricula, as well as a potential collaborator within the applied research.
3. The Professional College of Tirana is engaged in a series of European projects such as: Erasmus + CBHE, the Jean Monnet Module and pilot projects of mobility in professional education supported by the EU, increasing the opportunities for students and academic and administrative staff to be trained.

Weaknesses

1. Lack of an updated study of the labor market. [Standard I/Criterion 4]
2. Lack of a proper analytical report of the benefits from the cooperation agreements clearly specifying the benefits for each study program offered. [Standard I.2/Criterion 2, Criterion 3]
3. Lack of a detailed annual report of IQAU as a summary of the various fields of action of the Institution, in accordance with the quality standards. [Standard I.3/Criterion 3]

Recommendation

1. Designing a 3-5year study of the labour market for this study program.
2. Annual drafting of a genuine analytical report of benefits from cooperation agreements.
3. Drafting of a detailed annual report of IQAU as a summary of the various fields of action of the Institution, in accordance with the quality standards.
4. Review of the division of the activities according to learning components C, D and E in accordance with DCM Nr. 185, dated 25.03.2021.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushjen pjesërisht	Përmbushjen kryesisht	Përmbushjen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

